

| Nr | Ngjarje vendore dhe ndërkombëtare të dukshmërisë dhe informimit (konferenca, treyza të rrumbullakta, punëtori, seminare, ngjarje, shkolla verore etj)  | Vendi  |
|----|--|--|
| 1  | Konferenca DiGiDay. Konferenca DiGiDay 2019, është organizuar në bashkëpunim me Universitetin e Podgoricës, Malit të Zi, Universitetin e Korçës “Fan S. Noli”, Shqipëri, Universitetin e Elbasanit “Aleksander Xhuvani”, Shqipëri, Universitetin “Nënë Tereza”, Shkup, Maqedoni Veriore, Universitetin e Vlorës “Ismail Qemajli”, Shqipëri dhe Universitetin e Mitrovicës, “Isa Boletini”, Kosovë.   | Gjilan   |
| 2  | Konferencat e BUA 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020. Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan është anëtar themelues i Asociacionit të Universiteteve të Ballkanit (BUA). Konferenca e BUA 2019 synonte të sigurojë një platformë shkencore të nivelit të lartë për të diskutuar gjerësisht këto çështje. Temat variojnë nga Bujqësia dhe Pyjet, Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Projektet Evropiane në Vlerësimin e Cilësisë dhe Sigurimin e Cilësisë në Arsim së bashku me Ndikimin e Universiteteve në Ekonomitë Lokale dhe Rajonale. Konferenca e Rektoreve Kosovë  | Bullgari, Turqi, Turqi, Maqedoni e Veriut, Greqi, Rumani |
| 3  | Konferencat e Rektoreve në Kosovë. Universitetet Publike në Kosovë kanë organizuar Konferencën e Rektorëve, me anë të së cilës do të diskutoheshin çështjet e rëndësishme rreth arsimit të lartë në Kosovë dhe probleme që ballafaqohen këto universitete. Konferenca e Rektorëve ka dalë më disa rezoluta dhe reagime për çështje të ndryshme të cilat kanë prekur direkt universitetet dhe arsimin e lartë në Kosovë. Udhëheqës i kësaj Konference janë Rektorët, të cilët këtë funksion e ushtrojnë me rotacion. Tani UKZ ka marrë udhëheqjen e kësaj Konference.   | Kosovë   |
| 4  | Konferenca e Rektorëve të universiteteve shqiptare. Konferenca e Rektorëve të universiteteve shqiptare është e obliguar të merret me temat të cilat janë diskutuar nëpër këto Konferenca, e që ishin nga më të ndryshmet si: Drejtimi i Univeristetit Publik, Autonomia, Strukturat dhe Gjithëpërfshirja; Ndërkombëtarizimi i Universiteteve Publike, Sfida dhe perspektiva; Potenciali i pashfrytëzuar i menaxhimit të cilësisë: Kurrikula Universitare dhe punësimi.   | Shqipëri   |
| 5  | Konferenca e Rektorëve të Evropës Juglindore 2019, ku UKZ gjatë konferencës së Forumit të katërt të Rektorëve të Universiteteve të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor, është bërë anëtar i Forumit të Rektorëve të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor, 24 prill 2019. Rektori i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, ka marr pjesë në Forumin e katërt të Rektorëve të Universiteteve të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor që po mbahet në Podgoricë, respektivisht në Universitetin e Malit të Zi.Me këte rast, Universiteti “Kadri Zeka” është bërë anëtar i Forumit të Rektorëve të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor. Ndërkohë, në këtë Forum po marrin pjesë rektorë dhe përfaqësues të rreth 30 njësive universitare, të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor. | Mali i Zi,   |
| 6  | Konferenca e Erasmus + dhe UKZ si Praktikant më të mira. Në Bibliotekën Kombëtare në Prishtinë, është mbajtur konferenca informuese e Zyrës së Erasmus + në Kosovë mbi shpalljen e programit dhe thirrjes së radhës nga EACEA. Në kuadër të këtij sesi, kanë marr pjesë të gjitha Institucionet e publike dhe private të Arsimit të Lartë në Kosovë, përfaqësues nga MASHT si dhe studentë. Ky sesion informues ka qenë tejet i rëndësishëm për UKZ-në pasi që Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar ka qenë i ftuar të bëjë prezantimin në sessionin e Best Practices, ku është bërë një prezantim i detajuar i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve dhe proejktit QUADIC si kordinator.   | Kosovë   |

|    |  |           |
|----|--|-----------|
| 7  | Konferenca e Cluster Meeting në Prishtinë. Në organizim të Komisionit Evropian dhe Zyrës së Erasmus + në Prishtinë, është organizuar Konferenca me temë: "Impact of Erasmus+ Capacity Building Higher Education (CBHE) projects on reform and modernisation of Higher Education system in Kosovo". Në këtë konferencë janë prezantuar projektet e ngritjes së kapaciteteve dhe UKZ është prezantuar si best practices me rojektin QUADIC dhe për implementimin e mirë të të gjitha objektivave të tij. Kjo Konferencë është mbajtur online për shkak të situatë pandemike me COVID 19.   | Kosovë    |
| 8  | Në organizim të Komisionit Evropian dhe Seksionit të programit ERASMUS+, UKZ ka marrë pjesë në Konferencën "Regional Cluster Meeting – Capacity Building in Higher Education -projects' impact in the Western Balkans". 23 tetor 2019. Në organizim të Komisionit Evropian dhe Seksionit të programit ERASMUS+, në Durrës të Shqipërisë, po i zhvillon punimet Konferenca "Regional Cluster Meeting – Capacity Building in Higher Education -projects' impact in the Eastern Balkans", në të cilën kanë marrë pjesë Rektori i Universitetit "Kadri Zeka", dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave Aplikative. Gjatë Konferencës, punimet janë zhvilluar nga fusha e bashkëpunimit regjional, modernizimit, çasjes dhe internacionalizimi në Arsimin e lartë, duke u trajtuar impakti i projekteve të realizuara dhe që janë në proces të realizimit nga programi Erasmus+, si: ELEMEND, TEACHER, TEAVET, REBUS, e-VIVA. Ndër tjerash në sesionin e parë janë elaboruar rezultate e arritura nga projektet e Erasmus+, në ndërlidhjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë me shoqërinë dhe tregun e punës, në ngritjen e cilësisë dhe internacionalizimit të arsimit të lartë, në promovimin e reformave të arsimit të lartë në nivelet kombëtare dhe regjionale, si dhe në thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të arsimit të lartë të vendeve të Ballkanit Perëndimor. | Shqipëri  |
| 9  | Universiteti "Kadri Zeka" në bashkëpunim me Kolegjin Universum ka organizuar konferencën për projektin e-VIVA, projekt ky i financuar nga programi Erasmus + të Bashkimit Evropian. Konferenca ka trajtuar temën "Enhancing and Validating service related competences in Versatile learning environments in Western Balkan Universities". 23 dhjetor 2019. Duke sjellur risi në fushën e arsimit në Kosovë, Projekti e-VIVA adreson çështjet që synojnë të punojnë në industrinë e zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve. Pjesë e kësaj konference përveç përfaqësuesve të institucioneve përkatëse ishin të ftuar. Projekti synon të evidentojë kompetencat më themelore për ekonominë e shërbimeve dhe do të kontribuojë në transparencë më të lartë të tyre, për studentët, mësuesit dhe punëdhënësit.  | Kosovë    |
| 10 | Konferenca IAFES. Në Konferencë u prezantua edhe Universiteti "Kadri Zeka" me projektin "The advantages of creating a neë account in Moodle by users themselves and not by the administration" përgatitur nga profesorët: Basri Ahmedi, Xhevdet Thaqi dhe Ekrem Halimi. Prezentimin para ekspertëve dhe pjesëmarrësve të konferencës e bëri dekani dhe prodekani i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike Universitetin "Kadri Zeka".  | Greqi     |
| 11 | Konferenca për shkëmbimin e përvojave të bashkëpunimit ndërkombëtar. Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, bashkë me Prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar, kanë marr pjesë në konferencën organizuar në Vjenë të Austrisë për shkëmbimin e përvojave të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe krijimin e lidhjeve më të forta mes UKZ-së dhe universiteteve më të njohura në Evropë, e që janë pjesë e kësaj konference, si Universiteti i Vjenës, Zurichut, Rigas, Portsmouthit, Lodzit, etj.  | Austri    |
| 12 | UKZ pjesë e konferencës shkencore "The Balkans in the European Integration", në organizim të Sofia University St. Kliment Ohridski që është  | Bullgaria |

|    |  |                   |
|----|--|-------------------|
|    | mbajt në kuadër të Samitin e BE-së, në të cilin Samit i është konfirmuar edhe një herë vendeve të Ballkanit perspektiva e integritimit në UE, 16 maj 2018.   |                   |
| 13 | Konferenca në UKZ “Vlerësimi dhe rezultatet e para të Pilot Projektit: Klasa e I-V, qasja me mësimdhënës lëndor  | Kosovë            |
| 14 | Konferenca e përbashkët e UKZ dhe MTU. Kjo konferencë është organizuar nga Universiteti “Kadri Zeka” bashkë me Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup, për zhvillimin e qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor.   | Shqipëri          |
| 15 | Shkolla Verore në Universitetin e Selanikut. UKZ së bashku me Universitetin e Selanikut ka organizuar shkollën verore në Selanik. Në këtë shkollë UKZ ka dërguar një numër të studentëve.  | Greqi             |
| 16 | Konferenca shkencore ndërkombëtare “Marrëdhëniet e popullit shqiptar me Austro-Hungarinë (Austrinë) nga shek. XIX e deri në ditët tona”, organizuar nga Universiteti “Kadri Zeka”, UBT-së, Universitetit “Hasan Prishtina”, Institutit për Studime Politike dhe Ndërkombëtare me seli në Shkup, si dhe me Shtëpinë botuese “LogosA”, Shkup, 9 shtator 2016.  | Maqedoni e Veriut |
| 17 | Instituti për Studime Ligjore dhe Demokratike (ISLD) në bashkëpunim me Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan kanë bashkë organizuar konferencën e IV-të Shkencore Rajonale me temë: “Ndryshimet në shoqëri përmes reformave, me theks të veçantë në arsim, drejtësi dhe ekonomi”, 29 mars 2016.   | Kosovë            |
| 18 | Mbledhja konstituive e Konferencës së Rektorëve, Qershor 16, 2016  | Kosovë            |
| 19 | Konferenca shkencore mbarëshqiptare kushtuar 130-vjetorit të mësonjëtores së parë shqipe, në bashkëpunim me Universitetin “Fan S. Noli” Korçë, Universitetin “Kadri Zeka” Gjilan, Universitetin e Tiranës, Universitetin “Hasan Prishtina” Prishtinë, Universitetin e Shkupit, kanë organizuar konferencën mbarëshqiptare “130 vjet Mësonjëtorja e Parë Shqipe-vatër e arsimimit, emancipimit dhe ngritjes së vetëdijes kombëtare të shqiptarëve”, 6 Mars 2017 | Shqipëri          |
| 20 | Në Riga të Letonisë u mbajt Konferenca e ATEE, ku anëtar me të drejta të plota i të cilës është Universiteti Kadri Zeka, 15 maj 2017   | Letoni            |
| 21 | Konferenca ndërkombëtare, “Plagjiatura në Evropë dhe Përtej / Plagiarism across Europe and Beyond 2017”, 25 MAJ 2017.  | Czech Republic    |
| 22 | Në Londër të Mbretërisë së Bashkuar është mbajtur Konferenca Cloud Computing 2017 e sponzoruar nga IEEE, në të cilën ka marrë pjesë UKZ, 18-20 korrik 2017.  | Britani të Madhe  |
| 23 | Në Universitetin “Fan S.Noli” në Korçë, është organizuar Konferenca Ndërkombëtare me temën “Interregional developments in geographical, historical, social, economical and cultural focus”, më 3 Nëntor.   | Shqipëri          |
| 24 | Në Konferencën e I-rë regjionale për Teknologji Informative dhe Komunikim nën organizimin e Komunës së Gjilanit, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan ka prezantuar Fakultetin e Shkencave Kompjuterike si promotor i projekteve të TI, më 27 shkurt 2018.   | Kosovë            |
| 25 | Në Korfuz të Greqisë në Konferencën e Asociacionit Ndërkombëtar të e-shkencës IAFeS (International Association for e-Science, Universiteti “Kadri Zeka” është prezantuar me projektin “The advantages of creating a new account in Moodle by users themselves and not by the administration“, 7 maj 2018.  | Greqi             |
| 26 | Universiteti “Kadri Zeka” prezantuese në Konferenca Përmbyllëse të projektit Erasmus Mundus GreenTechWb që është mbajt në Mal të Zi, respektivisht në Podgoricë, 10 maj 2018.  | Mali i Zi         |

|    |   |                   |
|----|---|-------------------|
| 27 | Universiteti Nëna Terezë në Shkup në bashkëpunim edhe me Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan, ka organizuar Konferencën Ndërkombëtare, me temën: “Zhvillimi i qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor: qasjet, mangësitë dhe sfidat”, 02-03 nëntor 2018.   | Maqedoni e Veriut |
| 28 | Konferenca e Rektorëve e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 21.01.2019, shqyrtoi Njoftimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë rreth vendimeve për tërheqjen e akreditimit dhe refuzimin për 42 programe studimore.  | Kosovë            |
| 29 | UKZ pjesë e konferencës së rektorëve të universiteteve publike shqiptare e titulluar “Arsimi i lartë shqiptar dhe ballafaqimi me të ardhmen”. Në këtë konferencë morën pjesë rektorë dhe zëvendësrektorë nga universitetet publike shqiptare në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, 16 shkurt 2019.  | Shqipëri          |
| 30 | UKZ pjesëmarrëse e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare “Strategjia për zhvillim ekonomik lokal të komunave në vendet e Ballkanit me theks të veçantë pikëpamjet, sfidat dhe mundësitë e zhvillimit”, e organizuar nga Instituti për Kërkime Shkencore dhe Zhvillim në Ulqin, 8 prill 2020   | Mali i Zi         |
| 31 | Konferenca e Rektorëve të Evropës Juglindore 2019. Rektori i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, ka marr pjesë në Forumin e pestë të Rektorëve të Universiteteve të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor që po mbahet në Ljubljane, respektivisht në Universitetin e Ljubljanes.   | Sllloveni         |
| 32 | Konferenca e Rektorëve të Universiteteve Publike të Kosovës,ka organizuar konferencën “Akreditimi dhe Cilësia në Arsimin e lartë”. 18 dhejtor 2019.   | Kosovë            |
| 33 | Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan k marrë pjesë në Konferencën e Konzorciumit të Projektit ResearchCult, “Përmirësimi i kulturës kërkimore në arsimin e lartë në Kosovë”. 24 shkurt 2020  | Kosovë            |
| 34 | Universiteti “Kadri Zeka” pjesëmarrëse e Konferencës së II-të të Rektorëve të Universiteteve Shqiptare me temë: “Universitetet Shqiptare përballë sfidave të hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë”. 7 mars 2020.   | Shqipëri          |
| 35 | Konferenca ndërkombëtare, “Plagjiatura në Evropë dhe Përtej / Plagiarism across Europe and Beyond 2018”.  | Turkey            |
| 36 | Konferenca ndërkombëtare, “Plagjiatura në Evropë dhe Përtej / Plagiarism across Europe and Beyond 2019”.  | Lithuania         |
| 37 | Konferenca ndërkombëtare, “Plagjiatura në Evropë dhe Përtej / Plagiarism across Europe and Beyond 2020”.  | Dubai             |
| 38 | Në organizim të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, në bashkëpunim me GIZ-CDBE (Zhvillimi i Kapaciteteve në Arsimin Bazë), është mbajtur konferenca “Vlerësimi dhe rezultatet e para të Pilot Projektit: Klasa e I-V, qasja me mësimdhënës lëndor”.   | Kosovë            |
| 39 | Organizimi i vizitave studimore të studentëve nga PH Zug. 14 studentë të Universitetit të ZUG në Zvicër kanë arritur në Gjilan, si pjesë e shkëmbimit mes UKS dhe PH Zug, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit që Universiteti “Kadri Zeka” ka me Universitetin ZUG, në këmbim të mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve.Më pas studentët zviceran kanë zhvilluar një takim me Dekanin e Fakultetit të Edukimit Prof. Ass. Dr. Stafin Akademik i Fkultetit të Edukimit, kanë bashkëbiseduar rreth fushës së edukimit dhe mësimdhënies edukative.Ndërsa Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka, Asistenti Selim Daku si dhe zyrtarja për Bashkëpunim Ndërkombëtar Luljete Berisha bashkë me studentët zviceran dhe studentët gjilanas, kanë zhvilluar punëtorinë e përbashkët me temë “Roli i mësuesve në shkollë dhe shoqëri”. | Kosovë            |
| 40 | Organizimi i vizitave studimore të studentëve nga UKZ në Zug të Zvicrës. 20 studentë të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, kanë qëndruar për një vizitë studimore në Zvicër, respektivisht në Universitetin ZUG. Një pritje madhëitore u është bërë të gjithë studentëve të UKZ-së nga studentët e Zug,  | Switzerland       |

|    |  |                |
|----|--|----------------|
|    | të cilit ishin paraprakisht në vizitë dy muaj më hërët në Gjilan. Secili në mënyrën e vet, kishin përgatitur aktivitete të ndryshme në shënjë mirënjohje për mikëpritjen e bërë në Gjilan gjatë qëndrimit të tyre një javor.   |                |
| 41 | UKZ ka organizuar çdo vit Erasmus + Info Day   | Gjilan, Kosovë |
| 42 | Info Day nga Ambasada Franceze në Kosovë rreth mundësisë së studimit në Francë   | Gjilan, Kosovë |
| 43 | Info Day për studentët projektin e USAID “Up to youth”   | Gjilan, Kosovë |
| 44 | <b>Dita informuese për thirrjen e radhës për ERASMUS + 2020.</b> Këtë organizim, ku ishin të pranishëm menaxhmenti, stafi akademik, administrativ dhe studentët, U prezantuan mundësitë për stafin akademik dhe studentët me informacione të detajuara se si të aplikojnë për Shkëmbime afatshkurtëra/ International Credit Mobility (ICM); Master të përbashkët/ Erasmus Mundus Joint Master Degrees (EMJMDs); Projekte për ndërtimin e kapaciteteve në Arsimin e Lartë/ Capacity Building for Higher Education (CBHE); Projekte për Jean Monnet/ Jean Monnet Actions (JMA)   | Gjilan, Kosovë |
| 45 | <b>Konferenca « Të studiosh në Francë »</b> , qëllim i së cilës ishte të informojë studentët për mundësitë që ka në dispozicion Franca për të studiuar. Përfaqësuesit i informuan për mundësitë e bursave, shkëmbimeve, kushteve të regjistrimit dhe jetën e studentore në Francë. Ndryshe, vendet frankofone janë destinacionet kryesore për arsim universitar. Universitetet franceze janë ndër më të mirat dhe më prestigjiozët në botë.  | Gjilan, Kosovë |
| 46 | <b>Konferencë informuese për Aplikim në Raundin e 12-të, të Skemës Young Cell</b> , Programi i BE-së për bursa post-diplomike Ky takim është organizuar, pasi që zyra e Bashkimit Evropian dhe Ministria e Integritimit Evropian, kanë hapur e konkursin për Raundin e 12-të të aplikimit në Skemën Young Cell, programi i BE-së për bursa post-diplomike për Kosovën, i cili aktualisht është duke u implementuar nga British Council.  | Gjilan, Kosovë |
| 47 | <b>Konferencë informuese për Aplikim në programin Global UGRAD 2019-2020-</b> Zyrtarë nga zyra Amerikane në Kosovë, kanë qëndruar në UKZ, ku janë pritur nga Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar Dukagjin Leka, i cili në emër të rektorit Bajram Kosumi ka falënderuar zyrën Amerikane për ofrimin e mundësive të mira për studentët e UKZ-së. Ligjëratë “Java kundër Korrupsionit”, Agjencia Kundër Korrupsionit, respektivisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, ka organizuar një ligjëratë me temën: “Luftimi i veprave penale të korrupsionit”.  | Gjilan, Kosovë |
| 48 | <b>Info day në Tiranë.</b> Përfaqësues nga disa institucione të Arsimit të Lartë nga Holanda kanë ardhur në Tiranë, me qëllimin që të krijojnë ura bashkëpunimi me universitetet në Ballkan. Pjesëmarrës nga UKZ ishin rektori dhe dy prorektorë.<br>UKZ ka qenë pjesëmarrëse edhe në panairë të ndryshme që janë organizuar në Kosovë, me qëllim të informimit të opinionit mbi programet, mënyrën e studimit, organizimet, aktivitetet, arritjet e studentëve si dhe profesionistëve, për të cilët sot ka nevojë vendi ynë dhe më gjerë. se qfarë ofron universiteti jonë për studentët e ardhshëm, kushtet dhe mënyrën e studimit si dhe qfarë ofron për komunitetin për ndryshimin e kushteve. Në vijim po iu paraqesim panairët e përmendura. | Shqipëri       |
| 49 | <b>Panairi dhe dita informuese e UKZ-së “Fillo me një ëndërr, përfundo me një të ardhme!”</b><br>Universiteti “Kadri Zeka”, ka mbajtur ditën informuese për maturantët, të cilët përmbyllën një rrugëtim tejet të rëndësishëm. Duke e ditur se tani secili nga ta është përballë zgjedhjes për të vendosur rreth programeve të studimit,   | Gjilan, Kosovë |

|    |   |                   |
|----|---|-------------------|
|    | studentët e UKZ-së, përmes shpërndarjes së informatorëve, broshurave, të punuara nga stafi i Universitetit.   |                   |
| 50 | <p><b>Panairi i bashkëpunimit. “Krijojmë Partneritet”</b></p> <p>Në organizimin e fakultetit Ekonomik, studentët dhe stafi akademik i këtij fakulteti me aktivitete të ndryshme ka shënuar 5 vjetorin e themelimit të UKZ-së. Fillimisht është organizuar Mini – panairi ekonomik, në të cilin kanë marrë pjesë 14 prodhues nga vendi dhe më gjerë, si: Rc Cola – Gjilan, Flexograf – Gjilan, Calabria (Industria e Mishit) – Gjilan, Banja Nena Naile – Kllokot, Agro Adria (Industria e Mishit) – Bujanoc, BKT – Gjilan, Banka Ekonomike – Gjilan, Scardian – Gjilan, Vipa Chips – Vushtrri, Protec – Gjilan, Kep – Gjilan, KIT – Kosove, Information Technology – Prishtine, AIO Technology – Prishtine dhe Toni Commerce – Prishtine. Në përfundim është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi mes Universitetit “Kadri Zeka” dhe kompanive pjesëmarrëse në minipanairin ekonomik nën moton “krijojmë partneritete”.</p>                                      | Gjilan,<br>Kosovë |
| 51 | <p><b>UKZ organizatore e Panairit të Punës</b></p> <p>Universiteti “Kadri Zeka” ka marrë pjesë në Panairin e Punës në Gjilan, duke prezantuar punën dhe aktivitetet tija, që njëherësh janë të paraqitura edhe në Informator të ndryshëm. Po ashtu në këtë panair, UKZ ka promovuar edhe programet e studimit që ofron për studentët e rinj. Ndryshe të enjten në Gjilan është hapur Panairi i Punës, i cili organizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), Komunës së Gjilanit, Agjencinë Për Zhvillim Rajonal – Lindje dhe Zyrën Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ).</p>   | Gjilan,<br>Kosovë |
| 52 | <p><b>Panairi i Studimeve në Gjilan</b></p> <p>Në kampusin e shkollave të mesme në Gjilan, është hapur Panairi i Studimeve të universiteteve të Kosovës dhe regjionit, ku Universiteti “Kadri Zeka” ka bërë prezantimin e profileve që ofrojnë për këtë vit akademik si dhe sukseset e veçanta shkencore që ka ky institucion akademik nëpër vite. Panairi me përfaqësues të shumtë nga universitetet e ndryshme të Kosovës dhe regjionit, është përcjellur me një kureshtje të madhe nga maturantët e shkollave të Gjilanit.</p>   | Gjilan,<br>Kosovë |
| 53 | <p><b>Panairi Virtual të Karrierës</b></p> <p>Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan ka marrë pjesë në panairin Virtual të Karrierës që është mbajtur në Sallën 1 Tetori në Prishtinë, organizuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, respektivisht Qendra për Zhvillim të Karrierës dhe mbështetur nga projekti partner DIMAK Kosova – GIZ .</p> <p>Në këtë panair UKZ ka ofruar për pjesëmarrësit, sidomos për maturantët dhe të diplomuarit, informacione rreth mundësive për orientim dhe zhvillim në karrierë, punësim, punë praktike, bursa, trajnime, kurse, etj., si dhe rreth orientimit të studentëve të ardhshëm për programet studimore që ofron Universiteti ynë. Gjatë panairit kishte një interesim të madh të maturantëve të shkollave të mesme të Komunave të Kosovës, për Universitetin “Kadri Zeka”, respektivisht për programet dhe ofertat akademike, që më pas ata, të mund të orientohen se ku do t’ i vazhdojnë studimet.</p> | Gjilan,<br>Kosovë |
| 54 | <p><b>UKZ ka mbajtur punëtorinë dhe ka krijuar fokus grupin e bizneseve që ofrojnë shërbime në kuadër të projektit Easmus+ eVIVA</b></p> <p>Në kuadër të projektit E-viva, në Universitetin “Kadri Zeka” është mbajtur fokus grupi me disa përfaqësues të bizneseve në Gjilan. Fillimisht ata janë njoftuar me projektin në fjalë, derisa ka falënderuar për pjesëmarrjen në këtë fokus-grup. Në këtë takim është biseduar në përgjithësi për arsimimin në lidhje me kompetencat që ndërliken me shërbimet, e në veçanti për marketingun, mbështetjen e palëve të treta, ofrimin e edukimit rreth</p>   | Gjilan,<br>Kosovë |

|    |  |                   |
|----|--|-------------------|
|    | kompetencave që ndërlihen me shërbimin, metodologjinë dhe Kompetencat e ndërlihdura me shërbimin dhe Validimin. Projekti E-viva është një projekt i financuar nga Erasmus + me 16 partnerë, për një kohëzgjatje prej tre vjetësh.  |                   |
| 55 | <b>UKZ ka organizuar punëtorinë dhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me biznese në kuadër të projektit Erasmus+ EUFORIA</b><br>Në kuadër të UKZ ekziston edhe Bordi Industrial i themeluar nga ana e Biznesve të Komunave (Gjilan, Kamenicë, Viti, Kllokot, etj), me të cilët UKZ mban takime së paku dy here në vit rreth aktiviteteve të përbashkëta, që kanë synim zhvillimin e UKZ-së dhe po ashtu plotësimin nevojave të bizneseve rreth kuadrove, hulumtimeve, etj. UKZ ka marrëveshje bashkëpunimi me afër 20 biznese, për punë praktike të studentëve, hulumtime dhe aktivitete dhe ngjarje tjera me interes të përbashkët.  | Gjilan,<br>Kosovë |
| 56 | <b>UKZ ka organizuar konferencën për Projektin e studentëve për digjitalizimin e shërbimeve në Komunën e Gjilanit</b><br>Universitetit “Kadri Zeka” dhe Komunës së Gjilanit kanë arritur bashkëpunim për digjitalizimin e shërbimeve të Stacionit të Autobusëve dhe shkollave të mesme në Gjilan. Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike kanë prezantuar punën e tyre në përpilimin elektronik të orarit mësimor, ueb faqes së shkollave, digjitalizimin të punës dhe shërbimeve në stacionin e autobusëve si dhe aplikacionin për menaxhimin e pagesave dhe shërbimeve hoteliere me qëllim të përmirësimit të shërbimeve për publikun me këtë rast shkollat dhe ndërmarrjet, e në të ardhmen edhe institucionet tjera publike dhe rrjetin e bizneseve në përgjithësi. | Gjilan,<br>Kosovë |
| 57 | UKZ së bashku me USAID kanë organizuar Konferencën për të drejtat e femrave në trashëgimi. <b>“Të Drejtat e Njeriut – Garantimi i të drejtave pronësore të barabarta në Kosovë”</b> . Në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan, është mbajtur ligjëratë e hapur me temën e lartcekur. Qëllimi i kësaj ligjërate ishte që t’u ofrojmë studentëve informata mbi rëndësinë e garantimit të të drejtave të barabarta pronësore për gratë dhe burrat në Kosovë, si dhe për sfidat ligjore dhe politike me të cilat ballafaqohet Kosova në realizimin e këtij objekti. Hulumtimet e Programit të USAID-it për të Drejtat Pronësore japin indikacione të bazuara se numri i grave që do të kenë pronë në emrin e tyre do të rritet me një ritëm të shpejtuar.                            | Gjilan,<br>Kosovë |
| 58 | UKZ së bashku me OSBE-në kanë organizuar punëtorinë me staf, studentë dhe pjesëmarrës të tjerë për demokratizimin dhe transparencën e institucioneve.  | Gjilan,<br>Kosovë |
| 59 | UKZ ka organizuar edhe programin GUEST Speaker, në të cilin program ftohen personalitete të shquara nga vendi, regjioni dhe Evropa për të mbajtur një ligjëratë nga fusha e arritjes së tij/saj. Deri tani janë organizuar një numër i ngjarjeve Guest Speaker, ku të ftuar kanë qenë personalitete të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare.  | Gjilan,<br>Kosovë |
| 60 | Joint European Union/Council of Europe International Conference / Konferencë Ndërkombëtare e përbashkët në mes Unionit Evropian dhe Këshillit të Evropës - Seminar "Cilësia e bashkëpunimeve ndërkombëtare" / Quality in International Partnerships, 8 Shkurt 2017   | Prishtinë         |
| 61 | <b>UKZ së bashku me Institutin Demokratik të Kosovës (KDI)</b> , ka zhvilluar punëtorinë “Keqpërdorimet që (s)i shohim” me studentët e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan. Në punëtori ku morën pjesë rreth 50 studentë, u diskutua mbi mënyrat se si duhet të kërkohet llogari për shfrytëzimin e parasë publike. Studentët që ndoqën këtë program u pajisën me certifikata pasi që u informuan se si bëhet identifikimi i flamujve të kuq në kontratat publike, si dhe për mënyrat se si duhen raportuar shkeljet që mund të rrjedhin si pasojë e menaxhimit të dobët të kontratave në prokurim publik. Kjo punëtori u   | Gjilan,<br>Kosovë |



|    |  |                   |
|----|--|-------------------|
|    | zhvillua në kuadër të projektit të financuar nga KFOS “Qytetarët për prokurim eficient dhe menaxhim të ndërgjegjshëm të parasë publike”.   |                   |
| 62 | <b>Trajnimet GIZ CDBE.</b> Në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan ka filluar trajnimet GIZ CDBE për studentët e Fakultetit të Edukimit. Programi “Mësimdhënia dhe të nxëniti klasa 1 – 5 të shkollës fillore”, ka për qëllim përvetësimin e këtij Programi , të zbatojë në klasat e tyre strategji, metoda dhe teknika ndërvepruese të mësimdhënies dhe të nxëniti, të cilat mundësojnë ndërtimin dhe krijimin e dijeve të nxëniti, formimin e shprehive dhe zhvillimin e kompetencave të nxëniti në përputhje me Kornizën e Kurrikulit dhe rezultatet e të nxëniti.  | Gjilan, Kosovë    |
| 63 | <b>UKZ dhe BIRN Kosovo,</b> në kuadër të konzorciumit kosovar në projektin e financuar nga Global Community Engagement and Resilience Fund – GCERF, kanë realizuar një trajnim për studentët e Fakultetit Juridiku në Gjilan, në lidhje me rregullat e raportimit për rastet e terrorizmit dhe ekstremizmit fetar.   | Gjilan, Kosovë    |
| 64 | <b>UKZ dhe Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN Kosova,</b> përmes skemës së mbështetjes nga Luksemburgu për shoqërinë civile në Kosovë, mbajti një trajnim për studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, me temën “Përmirësimi i Standardeve të Gazetarisë Hulumtuese përmes Përvojave të Përbashkëta”. Nga ky trajnim studentët përfituan njohuri të dobishme mbi etikën e gazetarisë dhe pasojat ligjore të raportimit të pasaktë. Po ashtu, studentët në këtë trajnim u njoftuan edhe me “Krypometrin”, platformë kjo që e ka aplikuar “Kallxo.com”, e cila merret me monitorimin, verifikimin e më pas publikimin e gënjeshtres së akterëve llogaridhënës. Në fund të këtij trajnimi studentët pjesëmarrës u pajisën edhe me certifikata për kontributin e dhënë në këtë aktivitet nga BIRN Kosova dhe partnerët e tjerë mbështetës të këtij trajnimi.            | Gjilan, Kosovë    |
| 65 | <b>GIZ</b> ka organizuar trajnimin profesional për Hulumtime Shkencore dhe Analiza të të Dhënave me SPSS.Zhvillimi i hovshëm teknologjik na vendosë në baza ditore para prognozave dhe informacioneve të shumta, për të cilat gjithsesi se duhet të kryhen hulumtime cilësore dhe të sakta. Për këtë qëllim, Dafina Turkeshi nga GIZ, për studentët e Fakultetit të Edukimit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, ka mbajtur trajnim profesional për Hulumtime Shkencore dhe Analiza të të Dhënave me SPSS (Statistical Package for Social Sciences), përmes të cilit synon të përgatisë studentët, që në natyrën e punës së tyre kanë të bëjnë me hulumtime sasiore, duke i vënë në përdorim pyetësorët.Trajnim është një mundësi unike për aftësim praktik se si aplikohet statistika dhe ekonometria në botën reale përmes softuerit më të përhapur aplikativ SPSS (Statistical Package for Social Sciences). | Gjilan, Kosovë    |
| 66 | <b>Parlamenti Studentor i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, në bashkëpunim me organizatën LIZA-R,</b> ka organizuar trajnimin për studentët rreth disa temave të ndryshme si: Shkrimi i projekt-propozimit, Planifikimi i buxhetit, Implementimi i projekteve, Menaxhimi i financave, Lidershipi, Puna grupore etj.Ditët informuese që mbahen me qëllim të informimit të studentëve me programet e jashtme për mundësinë e fitimit të bursave studentore, pjesëmarrjes nëpër konferenca ndërkombëtare, trajnimeve të ndryshme: sesioni informuese i programit të Zyrës së BE-së në Kosovë dhe Zyrës së Erasmus+, Program ky arsimor i Bashkimit Evropian, i cili synon modernizimin e sistemeve arsimore dhe përshtatjen e tyre me sistemet e Unionit Evropian;  | Gjilan, Kosovë    |
| 67 | si rezultat i marrëveshjes së bashkëpunimit që Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan ka me <a href="#">Universitetin e Mariborit në Slloveni</a> dhe me Shoqatën e verëtarëve të <a href="#">Kosovës</a> “Enologjia”, prodhues të verërave në Kosovë kanë marrë pjesë në <a href="#">garat e 10-ta ndërkombëtare,</a>  | Maribor, Slovenia |



|    |  |           |
|----|--|-----------|
|    | <p><a href="#">në Maribor të Sllovenisë</a>. <b>Garat e 10-ta ndërkombëtare të verërave janë</b> organizuar nga <b>Universiteti i Mariborit</b> dhe Universiteti “Kadri Zeka”, në të cilën kanë marrë pjesë gjithashtu mbi 10 vende të Unionit Evropian, të cilat do të dërgojnë përfaqësuesit e tyre në këtë garë. Universiteti “Kadri Zeka” çdo ditë e më shumë po krijon mundësi të reja për studentët, profesorët, por gjithashtu edhe për bizneset kosovare që tregun e punës ta zgjerojnë në nivel ndërkombëtar. UKZ në Gjilan dhe prodhuesit e verërave të Republikës së Kosovës sot morën dy çmime ndërkombëtare për cilësi në verë të bardhë dhe të kuqe. Me këtë rast, Rektori i UKZ-se, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi ka pranuar çmimin për vendin e parë në <a href="#">verë të bardhë dhe çmimin për vendin e tretë për verën e kuqe</a>.</p> |           |
| 68 | Në bashkëpunim me GIZ-in në kuadër të marrëveshjes është mundësuar pjesëmarrja në Konferencën ndërkombëtare “Labour market policy and employment promotion - Background and concepts”, 14-15 November 2017. International Conference held in GIZ Eschborn, Germany   | Germany   |
| 69 | Ligjëratë e hapur e organizuar nga Këshilli i Evropës /Open Lecture organized by Council of Europe “Academic Integrity with special focus on plagiarism and contract cheating” , 6 December 2017,  | Prishtinë |
| 70 | Tryezë e Rrumbullakët e organizuar nga Këshilli i Evropës /Round Table organized by Council of Europe “Round Table – Codes of Conduct in Higher Education / Kodet e sjelljes në arsimin e lartë, 16 Nëntor 2017  | Prishtinë |
| 71 | Seminar i organizuar nga Këshilli i Evropës / Seminar organized by Council of Europe “Seminar mbi Standardet etike në arsimin e lartë”, 2 Gusht 2017.  | Prishtinë |
| 72 | Komisioni Evropian “Horizon 2020 Info Days”, 30 Nëntor 2017  | Prishtinë |
| 73 | Tryezë e Rrumbullakët e organizuar nga Këshilli i Evropës /Round Table organized by Council of Europe “Round Table-Presentation of the findings of the Baseline Study on Issues Affecting Integrity in Higher Education/Tryezë e rrumbullakët-Prezantimi i të gjeturave të studimit rreth çështjeve që afektojnë integritetin në arsimin e lartë, 14 Mars 2017.  | Prishtinë |
| 74 | Joint European Union/Council of Europe International Conference / Konferencë Ndërkombëtare e përbashkët në mes Unionit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Horizontal Facility for the Western Balkans and Turkey”<br>- Fuqizimi i integritetit dhe lufta kundër korrupsionit në arsimin e lartë;<br>- Krijimi i një kulture demokratike në shkollë, 26 Janar 2017  | Prishtinë |
| 75 | World University Service (WUS) Austria Workshop / Punëtori “Developing student-centered learning methods at public universities in Kosovo with the design thinking methodology” , 5-6 Dhjetor 2017   | Prishtinë |
| 76 | World University Service (WUS) Austria Workshop - Workshop /Punëtori about the concept paper for profiling of Public HEIs, 7 Dhjetor 2017  | Prishtinë |
| 77 | Joint European Union/Council of Europe International Conference / Konferencë Ndërkombëtare e përbashkët në mes Unionit Evropian dhe Këshillit të Evropës - Seminar "Ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë -   | Prishtinë |

|    |  |           |
|----|--|-----------|
|    | Praktikat më të mira" / Internationalization of Higher Education – Best practices, 14 Dhjetor 2017   |           |
| 78 | Zyra e Erasmus + në Kosovë, Dita Informuese e programit Erasmus+ për Institucionet e Arsimit të Lartë, 7 Nëntor 2017   | Prishtinë |
| 79 | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në bashkëpunim me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH - Konferenca Ndërkombëtare “Të Veprojmë së Bashku për Arsim më të Mirë”, 1 Dhjetor 2017  | Prishtinë |
| 80 | Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH - Punëtoria Planifikuese e përbashkët të projektit të GIZ-it “Zhvillimi i Kapaciteteve në Arsimin Fillor në Kosovë/CDBE”, 2-3 Mars 2017   | Prishtinë |
| 81 | Rektori i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan u ka dhënë medaljet dhe diplomat fituesve, prodhues të verërave të Republikës së Kosovës , të cilët janë shpërblyer me dy çmime ndërkombëtare për cilësi në verë të bardhë dhe të kuqe në garën e dhjetë ndërkombëtare të organizuar nga Universiteti i Mariborit në Slloveni. Rektori Bajram Kosumi tha se, ky rast ka qenë një kënaqësi e veçantë sepse sipas tij çmime të tilla e nderojnë Universitetin “Kadri Zeka”, prodhuesit e verërave si dhe vendin – Republikën e Kosovës. ( <a href="https://www.uni-gjilan.net/lajmet/universiteti-kadri-zeka-ka-dhuruar-cmimet-nderkombetare-per-prodhuesit-vendor-te-vererave/">https://www.uni-gjilan.net/lajmet/universiteti-kadri-zeka-ka-dhuruar-cmimet-nderkombetare-per-prodhuesit-vendor-te-vererave/</a> ) | Gjilan    |

Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan, organizon dhe bashkëorganizon ngjarje të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare dhe të cilat informojnë studentët, stafin dhe komunitetin më të arriturat, trendët e zhvillimit të arsimit, bashkëpunimi dhe projektet, konferenca, simpoziume, trajnime me anë të së cilave zhvillon stafin. Të gjitha njësitë akademike dhe administrative bashkëpunojnë ngushtë në implementimin e ideve dhe projekteve që ndihmojnë në zhvillim profesional.